



**EDUKOJMË
MOTIVOJMË
FUQIZOJMË**

BULETINI
2016-2020



në shërbim të shoqërisë

I nderuari lexues,

Para jush keni përmbledhjen e shkurtër të veprimtarisë së Forumit Rinor Islam nga viti 2016 deri 2020. Një mandat që do të ketë në shënjestër aftësimin dhe aktivizimin e nxënësve dhe studentëve si dhe inkuadrimit të tyre në projektet rinore. Në vazhdim po japim një retrospektivë të shkurtër lidhur me aktivitetet më të dalluara që kanë karakterizuar vitet përkatëse.

Viti 2016, ishte vit që karakterizohet me njohjen dhe zhvillimin e brendshëm të kuadrit dhe aktivistëve të këtij asociacioni. Përderisa anëtarët e kryesisë qendrore u familjarizuan mes vete duke bërë një ristrukturim të departamenteve të FRI-së, nuk munguan aktivitetet e shumta me të rinjë të qyteteve të ndryshme të cilët janë promotorë dhe motivues të kësaj organizate. Ky vit shënoi edhe moton e re të Forumit Rinor Islam “Edukojmë, motivojmë, fuqizojmë”, që do të jetë orientimi jonë se si duam të punojmë, dhe si duam të duket një i ri/e re në shoqërinë tonë.

Viti 2017 do të fillonte me një projekt të ri dhe sfidues. “Planifikimi strategjik” së bashku me disa trajnime dhe ligjërata tjera do të organizohet në qytetin Bursa të Turqisë, seminar i cili mbledhi anëtarë nga të gjitha degët e Forumit Rinor Islam. Përkaj këmbimit të përvojave mes të rinjëve, do të kompletohej një planifikim strategjik disaveçar, dhe do të përgatitej një plan veprimi për vitin 2017. Si rezultat i një angazhimi të planifikuar, viti 2017 do të ishte i mbushur me aktivitete dhe ide të reja të cilat dhanë një kontribut të çmueshëm në promovimin e FRI-së dhe përkrahjen e nxënësve dhe studentëve. “Muzeu i Muhammedit (alejhis selam)” ishte një projekt i ri i cili këtë vit do të shfaqet për here të parë në Maqedoninë e Veriut, dhe do të ngjallte shumë kureshtje tek të rinjtë dhe popullata në përgjithësi.

Viti 2018 do të kujtohet si vit në të cilin do të kemi fokus edhe më të madh me të rinjtë e shkollave të mesme. Përveç projektit “Talentium”, i cili realizohej disa vite me radhë, në disa degë të Forumit Rinor Islam do të fillojnë të implementohen edhe dy projektet e reja “Eureka” në Shkup dhe “Sokratium” në Kumanovë, të cilët hapën një përvojë të re më shkollarët filloristë.

Viti 2019 do vazhdojë me një intenzitet të njëjtë të përkushtimit dhe punës me të rinjë dhe të reja të cilët ishin të etur për ngritje dhe zhvillim në sferën e komunikimit dhe medias. Promovimi i vlerave të mirëfillta islame dhe angazhimi për një rini të shëndoshë dhe stabile do jenë anët e forta për të cilat do të angazhohen aktivistët e palodhur.

Viti 2020 filloi me një entuziazëm dhe elan të ri për të punuar me të rinjtë tanë. Seminari “staff retreat” që do të



Fisnik Shabani, kryetar

organizohet në Strugë, do të mbledhë përsëri aktivistët dhe anëtarët më të dalluar të FRI-së për të përgatitur një plan të ri veprimi për vitin 2020 dhe për të këmbyer përvoja mes vete degët dhe departamentet. Pas këtij aktiviteti dhe rinisjes së disa aktiviteteve me të rinjë, do të përballemi me pandeminë globale “Covid 19” e cila do të ketë ndikimin e vet në veprimtarinë e organizatës sonë. Mirëpo përvoja dhe dëshira për të qenë pranë të rinjëve dhe aktivistëve tanë, do të ndikojë që edhe Fiumi Rinor Islam t'i përshtat aktivitetet e veta me nevojat dhe kërkesat e reja me qëllim që të jemi në kontakt të vazhdueshëm me aktivistët dhe të rinjtë tonë por edhe tju japim përkrahje dhe vullnet për tejkalimin e kësaj sfide. Viti 2020 gjithashtu është vit jubilar për Forumin Rinor Islam sepse këtë vit u shënuua 20 vjetori i themelimit të kësaj organizate dhe gjithashtu edhe 20 vjetori i manifestimit të mirënjohur “Në gjurmët e më të mirëve” me rastin e vitit të ri islam Hixhri.

Janë këto vite, që do mbahen mend për gjurmët që kanë lënë tek ngritja dhe edukimi i gjeneratave të reja. Jemi të vetëdijshëm se nuk kemi mundur të mbulojmë çdo sferë dhe mungesë që kanë nxënësit dhe studentët, por jemi munduar së bashku të gjejmë formën më të mirë të mundëshme për tejkalimin e sfidave dhe përmirësimin e gjendjes së shoqërisë sonë. Çmujmë shumë angazhimin dhe përkushtimin e të rinjëve dhe aktivistëve si dhe përkrahësve dhe bashkëpunëtorëve tanë për të përçar mesazhin tonë gjithandej.

Lusim Zotin Fuqplotë që të shpërblejë kontributin e secilit që u angazhua dhe u bë pjesë e aktiviteteve tona, dhe poashtu të lëshojë begati edhe në të ardhmen në këtë veprimtari.

Botues: **Forumi Rinor Islam**

Përgatiti: **Zyra për Marrëdhënie me Publikun**

Hafije Fejzuli, Zulejha Ramadani, Kujtesa Xheladini, Hafsa Sherifi

Fotografite: **Ahmed Sherifi, Amir Idrizi, Ebrar Sherifi**

Dizajni: **Ebrar Sherifi**

Tetor/2020

SHTRIRJA E FORUMIT RINOR ISLAM



SHKUP

Adresa: Rr. Krste Misirkov nr. 57a
lok. 2, 1000 Shkup, Maqedoni
tel. /faks.: + 389 2 3233 659
shkupi@fri.org.mk

KUMANOVË

Adresa: Rr. Karl Marks nr.16,
Lokaliteti Feniks, Kati I
1300 Kumanovë, Maqedoni
kumanova@fri.org.mk

TETOVË

Adresa: Adresa:Rr. Ilindenit, bl.
87/48, Kati I
1220 - Tetovë, Maqedoni
tel.: + 390 2 3233 659
tetova@fri.org.mk

GOSTIVAR

Adresa: Rr. Srecko Krstevski pn
1230 Gostivar, Maqedoni
gostivari@fri.org.mk

KËRÇOVË

Adresa: Qendra Tregtare H/R
Arabella, Kati I,
1300 Kërçovë, Maqedoni
kercova@fri.org.mk

PRILEP

Adresa: Crnilishtë
7500 Prilep, Maqedoni
prilepi@fri.org.mk

Vizioni ynë:

FRI synon të jetë udhëheqës në fushën e veprimtarisë rinore, zhvillimin e gjithëmbarshtëm shpirtëror, kulturor dhe moral të shoqërisë, në hap me trendet bashkëkohore.

Misioni ynë:

Promovimi dhe kultivimi i vlerave universale islame dhe humane; mbrojtja, aftësimi dhe fuqizimi i të rinjve.

Politikat tona:

Fokusimi në çështjet prioritare
Maturia dhe gradualiteti në veprim
Disiplina në realizimin e detyrave
Dialogu dhe partneriteti
Mbrojtja e identitetit kulturor
Fuqizimi i të rinjve


Vlerat tona:

Besimi
Vullnetarizmi
Përpikshmëria
Mesataria
Mirëkuptimi
Uniteti
Objektiviteti
Transparenca
Bashkëpunimi
Puna institucionale

Qëllimet strategjike:

- Avancimi i punës rinore
- Avancimi i punës edukative
- Ngritja e kapaciteteve kadrovike dhe institucionale
- Promovimi në media dhe opinioni publik
- Bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe ndërkombëtare, akademike, arsimore, OJQ dhe medime
- Qëndrueshmëria financiare e FRI-së

Struktura organizative e FRI-së:



*

Departamenti për të rinj
Departamenti për kulturë dhe sport
Departamenti për edukim
Departamenti i femrës

**

Dega Shkup
Dega Tetovë
Dega Kumanovë
Dega Gostivar
Dega Kërçovë
Dega Prilep

Zyra për Marrëdhënie me Publikun (ZMP)
Zyra për Projekte dhe Financa (ZPF)

ANËTARËT E KRYESISË QENDRORE TË FORUMIT RINOR ISLAM



Fisnik Shabani
Kryetar
2016-2020



Hasan Baftijari
Nënkryetar
2016-2020



Berat Limani
Nënkryetar
2016-2020



Xhabir Emini
Përgjegjës i
Departamentit të
Edukimit
2016-2020



Abdulhamid Mustafa
Sekretar Gjeneral
2019-2020
Kryetar - Dega
Shkup, 2016-2020



Mevlan Abazi
Kryetar Dega
Tetovë
2016-2020



Xhemal Ahmedi
Kryetar Dega
Kërçovë
2016-2020



Liridon Ismaili
Kryetar Dega
Kumanovë
2016-2020



Veton Ibraimi
Kryetar Dega
Prilep
2016-2020



Vullnet Selmani
Anëtar
2016-2020



Burhanedin Nuhiju
Anëtar
2018-2020



Sali Bislimi
Anëtar
2016-2018



Zubejda Murtezi
Përgjegjëse e
Departamentit të
femrës
2016-2020



Hafije Fejzuli
Përgjegjëse e
Zyrës për
Marrëdhënie me
Publikun
2016-2020



Zuljeta Fetaj
Përgjegjëse e
Departamentit për
të Rinjë
2016-2020

Raporti i vitit 2016

MANDATI I RI

Në fillim të vitit 2016, pas kuvendeve të degëve ku u zgjodhën kryesitë e reja, u mbajt edhe kuvendi i pestë zgjedhor i FRI-së. Në këtë kuvend u zgjodh kryetari i ri i FRI-së për mandatin katër vjeçar si dhe kryesia e cila përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë. Me propozim dhe miratim të kuvendarëve, kryetari i pestë i Forumit Rinor Islam u zgjodh Fisnik Shabani.



SHËNIMI I DITËVE TË VEÇANTA

Dita Botërore e Mbulesës

Në Kumanovë, Departamenti i Femrës shënoi 1 shkurtin me qëllimin për vetëdijesimin e shoqërisë për mbulesën si e drejtë themelore e secilës grua myslimane si dhe për eliminimin e paragjytimeve. Në shesh të qytetit u bë shpërndarja e fletushkave për mbulesën si dhe shumë vajza të reja provuan shaminë për të shënuar këtë ditë.



Dita Ndërkombëtare e Studentit

Për të shënuar këtë ditë, FRI organizoi panel diskutimi me temën “Roli i studentëve në ngritjen e cilësisë së arsimit”. Në panel u paraqitën tre studentët përfaqësues nga UEJL-i, IBU, USHT si dhe profesori universitar nga IBU, Mr. Emin Idrizi.



Dita e Mësuesit, 7 marsi

Dita e Mësuesit, gjatë këtij viti u shënua në Shkup dhe Kumanovë. Në shenjë respekti dhe vlerësimi për punën e tyre, FRI u shpërndau dhuratat mësuesve veteranë në pesëmbëdhjetë shkollat shqipe në Shkup dhe në rrethinë. Kurse, në Kumanovë u organizua kuizi i diturisë ku morën pjesë nxënësit e përzgjedhur nga tri shkollat e mesme shqipe të Kumanovës. Nxënësit garuan mes tyre në 4 kategori, kurse punën e tyre e përcolli komisioni i përcaktuar nga FRI.



Dita Ndërkombëtare e Shëndetësisë

Nëpër disa shkolla të Tetovës, aktivistet e FRI-së përkujtuan me këshilla nxënësit rreth dëmeve nga konsumimi i duhanit. Gjithashtu, nxënësit ndoqën edhe një dokumentar, i cili shtjellonte çështjen e konsumimit të duhanit si dhe efektet negative që shkakton në trupin e njeriut. Në fund u bë shpërndarja e fletushkave “Duhani, vesi i heshtur që vret”.



Akademi me rastin e 30 vjetorit të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe

Me rastin e 30 vjetorit të botimit të përkthimit të Kuranit, në Kërçovë u organizua akademi solemne. Të ftuarit e kësaj ngjarjeje, pos akademik Feti Mehdiu, ishin edhe asistenti i tij Liridon Kadriu dhe Mr. Ferit Zeqiri. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe kryetari i FRI-së, kryetari i komunës si dhe përfaqësues institucionesh. Përkthyesi, Akademik Mehdiu, u dekorua nga kryetari i FRI-së.



PROJEKTE ME NXËNËSIT DHE STUDENTËT

FRI shpërbleu semimaturantët më të mirë për vitin akademik 2015/2016

Nën moton “Të nxisim dijen, të investojmë për ardhmërinë”, u shpërblyen nxënësit më të mirë, gjatë vitit akademik 2015/2016, nga Shkupi, Tetova dhe Kërçova.

Maturantët e Shkupit në udhëkryqin e parë jetësor

FRI në bashkëpunim me unionet e nxënësve të shkollave të mesme të qytetit të Shkupit, organizuan trajnimin me temë “Orientimi profesional” me ligjërues Migjen Amzain – psikolog, i cili trajnim pati për qëllim orientimin e nxënësve në përzgjedhjen e profesionit.

FRI festë me maturantet e Kumanovës

Gjatë këtij organizimi solemn, FRI për maturantet dhuroi nga një dhuratë modeste, kurse shtëpia botuese “Furkan ISM”, nga Shkupi, dhuroi nga një komplet librash.

Trajnime dhe kurse falas

FRI organizoi trajnime dhe kurse falas për nxënësit dhe studentët:

- Trajnim me semimaturantët
- Kursi i Kuranit
- Kursi i fikhut
- Kursi i fizikës dhe kimisë


Përafërsisht 200 nxënës e studentë kanë kaluar në kurset e sipërpërmendura.



Dhurata për nxënësit

Me fillimin e vitit të ri shkollor, në gjashtë shkolla fillore dhe të mesme të Shkupit u shpërndanë fletushka me këshilla për nxënësit.

Dhurata u shpërndanë edhe për nxënësit e disa shkollave të Tetovës, me rastin e Vitit të Ri Islam, Hixhri 1438.



TALENTIUM

Projekti ka për qëllim mbështetjen e nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre në komunikim, motivimin e tyre për pjesëmarrje në jetën publike, nxitjen për të qenë bartës të proceseve të ndryshme me interesa rinore si dhe ngritjen e vetëbesimit për të shfaqur shkathhtësitë dhe talentin e tyre. Projekti përfshiu: ligjërata, ushtrime, vizita institucioneve dhe përgatitjet për garë.

Talentium 2015/2016 - Në maj të vitit 2016 u mbajt finalja e projektit Talentium, ku garuan në fjalime motivuese dhe me dokumentare nxënësit nga Shkupi, Kumanova, Tetova dhe Gostivari.

Talentium 2016/2017 - Këtë vitë, projekti filloi me nxënësit e Shkupit, Tetovës, Kumanovës dhe Gostivarit.



QENDRA RINORE

Mbyllja e vitit akademik 2015/16 - Me një ceremoni modeste u bë mbyllja e vitit akademik, me ç'rast edhe u dekoruan dy studentët më të mirë të kësaj qendre.

Hapja e vitit të ri akademik 2016/17 - Në hapjen solemne, për t'iu uruar suksese dhe vit të mbarë studentëve, fjalë rasti patën kryetari i FRI-së, Fisnik Shabani, kryetari i QMBI-së, Mr. Muhamed Murtezi dhe përgjegjësja e Departamentit të Femrës në FRI, Zubejda Murtezi.

Aktivitetet që realizohen në Qendrën Rinore:

- kursi i Kuranit dhe i fikhut,
- ligjëratat javore,
- takime,
- iftare vullnetare,
- shëtitje.

Për vitin 2016/17 në Qendrën Rinore të FRI-së banojnë 80 studentë.



RAMAZANI 2016

Shënimi i fillimit të muajit Ramazan

- Manifestimi tradicional “Mirë se erdhe muaji Ramazan” - Shkup.
- Shpërndarja e fleturimeve, imsakijeve dhe fletushkave - Shkup, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, Kërçovë.

Mbrëmjet Kuranore - Në ambiente të hapura, në Shkup, Kumanovë, Tetovë e Kërçovë, Forumi Rinor Islam organizoi Mbrëmjet Kuranore me lexues të shquar, si: hfz. Flamur Kasami, hfz. Armend Beqiri, hfz. Ajdin Aliji, hfz. Sufjan Ameti, hfz. Xhemail Nuhiju, hfz. Kreshnik Abdullahu.

Netët e Kulturës Islame - Me iftarin në qendër të qytetit, me 600 pjesëmarrës, filluan Netët e Kulturës Islame në Kumanovë. U realizuan aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike, si: kuizi me filloristët, fjalime motivuese, ekspozita e pikturave, shfaqja e filmit “Hakmarrja dhe Islami” si dhe u bë shitja e librave dhe ëmbëlsirave.

Mbrëmjet Islame - Departamenti i Femrës pranë Forunit Rinor Islam realizoi Mbrëmje Islame në Shkup, Tetovë dhe Kumanovë. Mbrëmjet u realizuan me programe të pasura fetare, kulturore e artistike, si: lexim të Kuranit, ligjërata, interpretim ilahish dhe monologjesh. Programe dhe ligjërata vetëm për femra u mbajtën edhe në Kërçovë, Gostivar dhe Prilep.



“Mirë se erdhe muaji Ramazan” - Shkup



Iftare - Departamenti i Femrës



Mbrëmje Islame - Departamenti i Femrës



Ilahi - Musli Musliu

Shporta e Ramazanit

Për ndihmë të nevojtarëve, jetimëve dhe skamnorëve, sivjet u siguruan mbi 5000 pako me produkte ushqimore elementare dhe u shpërndanë për familjet nevojtare. Në Kumanovë u realizua në bashkëpunim me Sh.E. "Vllaznia", kurse në Tetovë me O.H. "Kalliri i Mirësisë".

Iftare

Edhe sivjet u organizuan disa iftare, me aktivistë të FRI-së, me mysafirë dhe dashamirë. Kurse, në sheshin "Skënderbeu", në Shkup, u mbajt iftari i madh me mbi 500 pjesëmarrës, me përfaqësues të komunave, institucioneve, ambasadave, OJQ-ve si dhe përfaqësues tjerë nga sfera politike dhe intelektuale në vend.

Kokteje Bajrami

Pas përfundimit të muajit Ramazan, gjatë festës së Bajramit, u organizuan kokteje nëpër disa qytete ku vepron FRI-ja, me ç'rast festën e Bajramit aktivistët e FRI-së e pritën së bashku.





AKTIVITETE EDUKATIVE

Shkolla Verore

Sivjet, Shkolla Verore u mbajt në Shkup dhe Kumanovë, gjithsej me mbi 200 pjesëmarrës. U mbajtën ligjërata me hoxhallarë të ndryshëm, me tema për çështjet e moralit, çështjen e jurisprudencës islame dhe mbi çështjen e besimit. Poashtu, u realizuan disa vizita si dhe aktivitete sportive.

Grupet edukative

Gjithsej mbahen 22 grupe edukative me rreth 170 pjesëmarrës, anëtarë të FRI-së. Grupet mbahen në Shkup, Kumanovë, Tetovë, Gostivar dhe Kërçovë.



Netët imanore

Gjatë vitit 2016 janë realizur mbi 10 netë imanore në disa qytete ku shtrihet FRI-ja, në Shkup, Kumanovë, Tetovë, Kërçovë.

Ligjërata

Gjaë vitit janë realizuar më shumë se 200 ligjërata, të cilat organizohen nga Departamenti i Femrës, degët dhe nëndegët e FRI-së.





FESTA E BAJRAMIT TË KURBANIT

Aktivistet e FRI-së, në Tetovë, së bashku me shumë fëmijë të këtij qyteti sollën shkëndijat e para të festës së Bajramit të Kurbanit. Për fëmijët, u shpërndanë tullumbace dhe ëmbëlsira, për të ndarë kështu së bashku gëzimin e kësaj feste.

Poashtu gjatë kësaj feste u shtrua edhe tryeza e Bajramit në bashkorganizim me O.H. "Kalliri i Mirësisë". Të ftuar ishin shumë mysafirë, dashamirë e aktivistë të dy organizatave.



HIXHRI 1438

Për të gjashtëmbëdhjetën herë me radhë, Forumi Rinor Islam organizoi manifestimin tradicional të Vitit të Ri të kalendarit islam, Hixhri 1438. Ky manifestim përfshiu:

- Dekorimin e 21 nxënësve më të mirë nga shkollat e mesme të Maqedonisë.
- Dekorimin e hafizit 13 vjeçar nga Tetova, si hafizi më i ri i vitit.
- Ndarjen e çmimit “Shkencëtari i ri i vitit”, të cilin e fitoi Doc. Dr. Drita Mahmuti Fazlia.

- Dekorimin e personaliteteve për kontribut në shoqëri - u dekoruan personalitete për kontributin e madh kombëtar dhe fetar, rolin e pashembullt në ngritjen dhe zhvillimin e arsimit shqip si dhe për kontributin e dhënë në mbështetjen financiare të nxënësve e studentëve shqiptarë në Maqedoni.



- Dekorimin e 25 studentëve më të mirë në vend, nga Universiteti i Tetovës, Universiteti i Evropës Juglindore, Universiteti i Shkupit, Universiteti FON dhe Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik, prej të cilëve 9 studentë u dekoruan si më të dalluar, me notën mesatare 10.00.
- Ndarjen e çmimit të veçantë – dekorimi i dy studentëve për suksesin e arritur përkaj aftësive të kufizuara.



AKTIVITETE NJOFTUESE

Muaji rozë

Aktivitet me shkollaret e mesme për informimin e femrave dhe sensibilizimin gjatë muajit rozë.

Ditë e hapur në Tetovë

Njoftimi i vajzave të Tetovës rreth veprimtarisë së Departamentit të Femrës dhe FRI-së në përgjithësi.



Shënimi i ditës së flamurit

Nën moton *"Nëntori, muaji i ngritjes kombëtare"*, u shënua 28 nëntori, Dita e Flamurit. Tribuna u mbajt në temën *"Kontributi i Karadakut në çështjet kombëtare"*. Panelistë në këtë tribunë ishin prof. dr. **Minir Ademi**, profesor universitar si dhe **Ulusi Saliu**, kryetar i shoqatës së historianëve, të cilët para të pranishmëve paraqitën një kumtesë për kontributin e Karadakut në ecurinë e proceseve të ndryshme kombëtare dhe me theks të veçantë rolin e prijësve fetarë në po këtë çështje.



Shënimi i 3 dhjetorit

Në shkollën fillore "Liria" në Tetovë, anëtarët e FRI-së vizituan nxënësit që ndjekin mësimet në paralelen me nevoja të veçanta dhe u dhuruan dhurata modeste nga ana e FRI-së.



FUSHATA “TA NJOHIM MUHAMEDIN A.S.”

- Shpërndarja e fletushkave dhe thënieve profetike
- Ligjërata dhe programe
- Vizitë jetimëve dhe fëmijëve
- Panel diskutimi

Në këtë panel u paraqitën 5 studentët fitues nga konkursi për punime studentore i shpallur nga FRI, ku konkuruan gjithsej 12 punime studentore, si dhe hoxhë Qenan Ismaili, me temën “Jam ndihmuar nga të rinjtë”.



Manifestimi qendror i fushatës

Programi përfshiu lexim të Kuranit, fjalime, këshilla nga hoxhë Rufat Sherifi, interpretim të monologut “Tre hapat e gdhendjes” dhe ndarjen e çmimit “Hafiz Refik Ajeti”. Me këtë u përmbyll fushata, e cila zgjati pesëmbëdhjetë ditë.



AKTIVITETE SPORTIVE DHE REKREATIVE

U organizuan pikniqe dhe kampingje pranverore, verore si dhe dimërore, me anëtarët e aktivistët e Shkupit, Kumanovës, Tetovës dhe Kërçovës.

Gjithë degët e FRI-së realizuan edhe aktivitete sportive gjatë gjithë vitit.

Poashtu, u organizua edhe turneu tradicional "Muhamedali Jashari", i cili turne sivjet u organizua për të pestin vit me radhë.

Aktiviteti në fjalë pati karakterin garues dhe zgjati dy ditë. Morën pjesë 22 skuadra nga Shkupi dhe Kumanova dhe u luajtën 11 ndeshje kualifikuese. Për fituesit FRI ndau mirënjohje. Ndarjen e trofeut për skuadrën më të mirë të këtij turneu e bëri babai i të ndjerit Muhamedali Jashari. Mjetet e grumbulluara iu dedikuan familjeve skamnore.





VIZITAT FRI-SË DHE NGA FRI

FRI-në e vizituan mysafirë nga vendi e rajoni, përfaqësues institucionesh dhe të OJQ-ve. Poashtu, edhe kryetari i FRI-së vizitoi disa përfaqësues institucionesh të vendit.



MEDIA

- Paraqitja e aktiviteve në emisione televizive
- Paraqitja e aktiviteve në radio

Përfaqësues të FRI-së morën pjesë në disa emisione televizive dhe në radio, ku paraqitën aktivitetet e FRI-së. Poashtu, disa nga aktivitetet kryesore u emituan në televizionet lokale si edhe në edicionet qendrore të lajmeve pati informime rreth aktiviteve të FRI-së.

- Bashkëpunimi me portale

Aktivitetet e FRI-së u publikuan nga shumë portale si nga Maqedonia poashtu edhe nga Kosova e Shqipëria.



- Emisionet fetare nën moton **“Ramazani, muaj i vetëdijesimit”**

Emisionet u realizuan me personalitete nga Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria. Të njëjtit u transmetuan në disa televizione lokale.

- Letër urime dhe urime
- Letër ngushëllime dhe reagime
- Realizimi i videove të ndryshme
- Shënimi i 16 vjetorit të FRI-së
- Buletini i Ramazanit, përmbledhja vjetore



KUVENDET RAPORTUESE

Fillimisht u mbajtën kuvendet e degëve ku u raportua për aktivitetet në degët përkatëse gjatë këtij viti. Pastaj, u mbajt edhe kuvendi raportues vjetor i përgjithshëm dhe u miratua plani strategjik dhe ai akcional i Forumit Rinor Islam për vitin 2017.





Raporti i vitit 2017

PLANIFIKIMI STRATEGJIK I FRI-SË

Trajnimi u mbajt në Bursë të Turqisë, ku morën pjesë anëtarët e FRI-së nga e gjithë Maqedonia. Udhëheqës të punëtorive ishin kryetari i Forumit Rinor Islam, Fisnik Shabani si dhe nënkryetari, Berat Limani, në të cilët u diskutuan rreth aktiviteteve gjatë vitit 2016 si dhe planifikuan për vitin 2017.

Pjesë e programit ishte edhe ligjërata rreth sakrificës dhe vullnetit për punë të mira, ligjëruar nga teologu Hasan Baftijari.

Poashtu, pjesëmarrësit vizituan edhe komunën e Bursës, ku u pritën nga kryetari i saj, Rexhep Altepe, i cili shprehu mirënjohje si dhe gatishmëri për bashkëpunime të mundshme me FRI-në. Për kryetarin Altepe, kryetari i FRI-së ndau një dhuratë modeste.

Pas trajnimit pjesëmarrësit shëtitën disa vende karakteristike të këtij qyteti.



AKTIVITETET ME AKTIVISTËT

Aktivite Edukative

Ligjërata, takime të përbashkëta, grupe edukative, kursi i fikhut dhe i Kuranit, iftare vullnetare e mbrëmje imanore, u me aktivistët e FRI-së.

Seminare

Në Shkup u mbajt seminari “Vlerat e FRI-se” me qëllim njohjen e vlerave me të cilat zhvillon veprimtarinë FRI-ja.

Kurse në Kumanovë u mbajt seminari “Rrugëtimi drejt Zotit”, me ç’rast u paraqitën disa rrugë që çojnë në dashurinë për Allahun dhe inkurajimin e Islamit për optimizëm.

Pikniqe dhe Kampingje

Aktivite të lira argëtuese u zhvilluan në disa qytete, me qëllim përtëritjen pas angazhimeve gjatë një viti, pikniqet u realizuan me anëtarë e aktivistë në vende të ndryshme të Maqedonisë.



PARAQITJA E PROJEKTIT “MUZEU I MUHAMEDIT A.S.”

Ky projekt u paraqit për herë të parë në Maqedoni. Projekti pati për qëllim paraqitjen e jetës dhe veprës së të Dërguarit të fundit të Zotit, Muhamedit a.s, duke shfrytëzuar mjete teknike bashkëkohore. Muzeu u vendos në Çifte hamam, në Shkup. Hyrja për vizitorët ishte falas dhe ekspozita zgjati katër ditë. Muzeu i Muhamedit a.s. u vizitua nga shumë funksionarë, përfaqësues nga fusha politike, kulturore, arsimore, përfaqësues nga OSBE si dhe përfaqësues të organizatave turke, boshnjake e maqedone.



Gjatë katër ditëve të ekspozitës, numri i vizitorëve arriti deri në 3,000 persona, ku udhëheqësit profesionistë, bashkëpunëtorët e autorit të kësaj vepre, së bashku me autorin dhe aktivistët e FRI-së për katër ditë shpjeguan hollësisht rreth jetës dhe veprës së Muhamedit a.s. me anë të kësaj vepre.



SHËNIMI I DITËVE TË VEÇANTA

Dita Botërore e Mbulesës

Nën moton "Mbulesa ime, pjesë e bashkëveprimit tim me botën e jashtme" u zhvillua fushata mediatike pesëmbëdhjetëditore nga femrat anëtare të FRI-së. Shkrimet rreth mbulesës, sfidave dhe përkushtimit të mbajtjes së mbulesës në vendin tonë, thyerjes së paragjyqimeve si dhe tendencat në përkufizimin e një përzgjedhjeje, patën për qëllim përcjelljen e mesazheve deri te vajzat për veprime të vullnetshme dhe shoqërinë për gjykim të drejtë, mirëkuptim në zgjedhje dhe respekt për tjerët.



Dita e Mësuesit, 7 Marsi

Me rastin e 7 marsit, Ditës së Mësuesit, aktivistët e FRI-së shpërndanë fleturime për mësuesit. Shpërndarja u bë në shtatë shkolla të Shkupit, në katër shkolla të Kumanovës, në gjimnazin e përgjithshëm të Kërçovës, në tri shkolla të Tetovës dhe në dy shkolla fillore të Gostivarit. Ndërkaq, drejtorët e shkollave shprehën fjalë miradije për punën e FRI-së në edukimin dhe ndihmimin e të rinjëve në orientimin e tyre drejt rrugës së suksesit në jetë dhe shprehën gatishmëri për bashkëpunime të mëtejshme.



Dita Botërore e Shëndetësisë

Në Tetovë, në gjimnazin "7 Marsi", u organizua ligjëratë me temë "Depresion në këndvështrimin Islam". Para nxënësve të kësaj shkolle ligjëroi hoxhë Fevzi Musliu i cili përveç tjerash përmendi rolin e fesë në parandalimin e depresionit.



Dita Ndërkombëtare e Personave me Nevoja të Veçanta

Me rastin e 3 dhjetorit, anëtarët e FRI-së realizua një vizitë në qendrën ditore për persona me nevoja të veçanta dhe në shkollën fillore "Liria" në Tetovë – paralelen me nevoja të veçanta, me ç'rast nxënësve iu dhuruan dhurata modeste nga ana e FRI - së dhe disa ëmbëlsira. Ky aktivitet u mirëprit edhe nga nxënësit edhe nga drejtoritë përkatëse, ku njëherit drejtori i qendrës ditore, në shenjë falënderimi ndau mirënjohje për Degën e Tetovës.

AKTIVITETET ME NXËNËSIT DHE STUDENTËT

Ligjërata

Qindra ligjërata u realizuan nëpër gjithë qytetet ku vepron FRI-ja, me qëllim inkurajimin e studentëve e nxënësve drejt përkushtimit ndaj Zotit, kërkimin e modeleve për të qenë shembull në shoqëri e familje, formimi i personalitetit me vrytite të larta e sjellje të mirë.



Trajnime

Në bashkëpunim me unionet e nxënësve të shkollave të mesme të qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov", "Zef Lush Marku", "Cvetan Dimov" dhe "Maria Kiri Skllodovska" u organizuan trajnimet "Orientimi profesional" me psikologun Migjen Amzai dhe "Tejkalimi i krizave rinore" me teologun Qenan Ismaili.



QENDRA RINORE

Në Qendrën rinore të FRI-së gjatë vitit 2016/2017 banuan 80 studentë nga e gjithë Maqedonia. Gjatë këtij viti akademik, me studentët e kësaj qendre u zhvillua ky program: aktivitete edukative, aktivitete sportive dhe argëtuese, trajnime për studentët, përgatitje e punimeve studentore si dhe vizita dhe shëtitje.



SHPËRBLIMI I SEMIMATURANTËVE MË TË MIRË

Nën moton "Investo për diturinë, siguro ardhmërinë", u shpërblyen semimaturantët më të mirë në Tetovë, Kërçovë dhe Kumanovë.

Me këtë projekt, u dekoruan afër 60 nxënës të dalluar. Në Kërçovë, poashtu u shpërblye edhe talenti i vitit, u nda mirënjohje për akademinë e futbollit "Paris" dhe KF "Uskana" si dhe dekoratë postmortum për dy veteranë të arsimit.

TAKIM ME STUDENTËT NGA FAKULTETET E TURQISË

Nxënësit të pranishëm patën rastin që të informohen më shumë rreth përparësive për studime në universitetet e Turqisë, të cilët në mënyrë të detajuar i elaboruan studentët shqiptarë të cilët studiojnë atje duke treguar për eksperiencat e tyre.

Studentët nga: Universiteti Trakya - Edirne, Universiteti Tregtar i Stambollit si dhe Universiteti _ehir i Stambollit, treguan detajisht rreth jetës studentore në qytetet e Republikës së Turqisë.



“TALENTIUM” projekti që bashkoi nxënësit ambicioz

Projekti “Talentium” u realizua edhe këtë vit, tashmë për të katërtën herë me radhë. Ky projekt ka për qëllim mbështetjen e nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre në komunikim, motivimin e tyre për pjesëmarrje në jetën publike, nxitjen për të qenë bartës të proceseve të ndryshme me interesa rinore si dhe ngritjen e vetëbesimit për të shfaqur shkathhtësitë dhe talentin e tyre. Projekti zgjati katër muaj, i cili përfshiu ligjërata, ushtrime, vizita në institucione dhe përgatitjet për garë.

Me finalen e madhe të mbajtur në Gostivar, ku me fjalime motivuese garuan tetë nxënës nga 4 qytete, nga Shkupi, Kumanova, Tetova dhe Gostivari, u përmbyll projekti. Poashtu nxënësit pjesëmarrës përgjatë katër muajve u trajnuan edhe për përgatitjen e mini-dokumentareve, me të cilët poashtu garuan mes vete ditën e finales.



Nxënësit fitues u shpërblyen me nga një shumë simbolike të hollash dhe nga një komplet librash, kurse të gjithë finalistët u pajisën me certifikata.



AKTIVITETET SPORTIVE

Degët e FRI-së, gjatë vitit 2017, realizuan aktivitete të ndryshme sportive, kryesisht lojëra futbollistike. Kurse, në Shkup, tashmë për të gjashtën herë me radhë, u realizua turneu tradicional në futboll të vogël "Muhamedali Jashari". Në këtë turne morrën pjesë 36 skuadra të ndryshme nga Shkupi dhe rrethina. Mjetet e mbledhura nga participimi i skuadrave u shpërndanë për familjet skamnore.



RAMAZANI

MIRËPRITJE E MUAJIT RAMAZAN

Së bashku me shumë qytetarë u prit muajin Ramazan në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, me manifestimin tradicional "Mirëse erdhe muaji Ramazan".

Lansimi i fishekzjarreve, i përcjellë me salavate në fund të programit, solli shkëndijat e para të fillimit të muajit Ramazan. Ditët pas manifestimit për qytetarët shkupjanë u shpërndanë fletushka për vlerat e këtij muaji.

Shënimi i fillimit të muajit Ramazan u bë edhe në qytetin e Tetovës dhe në Kumanovë. Në këto dy qytete aktivistët e FRI-së shpërndanë fleturime, fletushka dhe imsakije. Poashtu, në Kumanovë u vendosën edhe banderola me attribute të muajit Ramazan.

MBRËMJET KURANORE

Mbrëmjet Kuranore, me lexues të shquar nga Maqedonia dhe Kosova, edhe sivjet u realizuan me sukses nga ana e Forumit Rinor Islam në katër qytete të vendit.

Lexuesit e dalluar, të cilët grumbulluan mijëra qytetarë me lexim nga Kurani Famëlartë, ishin: hfz. Hakim Iljazi, hfz. Armend Beqiri, hfz. Sallah Feta, hfz. Avdush Krosa, hfz. Xhemal Nuhiju dhe hfz. Egzon Ibrahim. Në Tetovë me lexim u paraqit edhe hafëzi më i ri i këtij qyteti, hfz. Almir Murati.



NETËT E KULTURËS ISLAME

Ky aktivitet, u realizua në sheshin e qytetit të Kumanovës, me program të pasur kulturor, artistik, fetar e arsimor për tri net radhazi.

Netët e Kulturës Islame u hapën me iftarin e madh në sheshin e qytetit, ku të pranishëm ishin rreth 600 qytetarë të shtresave dhe përkatësive të ndryshme.

Përveç kësaj, u mbajtën edhe fjalime motivuese dhe u interpretuan monologje nga nxënës të shkollave të mesme.

Gjatë këtyre netëve, u realizua program i pasur, që përfshi: kuizin e diturisë, fjalime motivuese, interpretim monologjesh, nuk munguan as këndi për fëmijë, ku fëmijët patën mundësinë të marrin pjesë në lojra të ndryshme si dhe me recitime. Gjithashtu u realizua edhe panairi i librave dhe ëmbëlsirave.



MBRËMJE ISLAME DHE KUIZI I DITURISË

Në Tetovë u organizua Mbrëmje Islame për femra, e cila u hap me fjalime përshëndetëse. Më pas filloi programi me lexim nga Kurani, vazhdoi me interpretim ilahish, shfaqje të dokumentarit “Pse agjërojnë myslimanët” si dhe interpretim dialogu dhe përmbyllja e programit u bë me interpretimin e monologut “Një muaj dhe një mijë muaj brenda tij”. Kurse, në Shkup u mbajt kuizi i diturisë vetëm për femra.



IFTARE

Iftari i madh me më shumë se 500 mysafirë, të shtresave e përkatësive të ndryshme, mes tyre përfaqësues të institucioneve, përfaqësues të organizatave joqeveritare, donatorë, studentë, u mbajt në sheshin "Skënderbeu" në Shkup. Këtë vit iftari u organizua në bashkëpunim me organizatën joqeveritare nga Republika e Turqisë "Iyilikder". Iftare u organizuan edhe në qytete tjera, me aktivistë, dashamirë, përkrahës të FRI-së.



LIGJËRATA

Ligjëratat gjatë këtij muaji u mbajtën për vlerën e lutjes, mënyrat e duhura për shfrytëzimin drejt të kohës në këtë muaj, veprat për rizgimin e zemrave drejt kthjelltësisë e pastrimit dhe për agjërimin si betejë individuale. Ligjëratat u mbajtën në disa qytete.




SHPORTA E RAMAZANIT

Shporta e Ramazanit gëzoi qindra familje nevojtare, me artikuj ushqimorë dhe gjëra të nevojshme për amvisëri. Në Kumanovë shportat u mblodhën në bashkëpunim me Sh.E. "Vllaznia" kurse në Tetovë me O.H. "Kalliri i Mirësisë". Aktivistët e FRI-së në të dy qytetet gjatë gjithë muajit pritën donatorët me ç'rast shportat e grumbulluara u shpërndanë disa herë gjatë muajit për jetimët e nevojtarët.



KONCERTI I BAJRAMIT

Me ilahi, tekbire e salavate u mirëprit festa e Bajramit të Fitrit në Kumanovë. Ky koncert u realizua në qendër të qytetit, me këndues të mirënjohur nga Maqedonia dhe Kosova, si: Egzon Ibrahim, Xhemail dhe Sabatin Nuhiju, Avdush Krosa, Avni Nebiu, Menduh dhe Deniz Allajbeg dhe Furkan Junuzi, të cilët para publikut kumanovar performuan ilahi të ndryshme. Në fund të programit, të gjithë kënduesit kënduan këngën e Bajramit, tekbire, salavate si dhe u bë lansimi i fishekzjarreve.



AKTIVITETET VERORE



U zhvilluan aktivitete edukative, përvetësim dijesh, përgatitje profesionale, ushtrime për shprehi të reja dobiprurëse, shëtitje. Ligjëratat me tematikë nga sfera e besimit, moralit si dhe jurisprudencës islame u ligjëruan nga teologët: Fevzi Musliu, Halil Ademi, Sumeje Peza, Esma Sh. Kurti dhe Hasan Baftijari. Ligjëruan në tema për etikën e besimtarit, motivimet drejt suksesit, aktivizimin e rinisë. Për të gjithë 70 pjesëmarrësit FRI ndau certifikata për përfundimin me sukses të Shkollës Verore 2017.



TRAJNIME NJËDITORE

Me trajnuesin Aluthman Abdulaziz Ahmed, FRI organizoi dy trajnime, njërin në qytetin e Tetovës dhe njërin në Kumanovë. Në temën "Kreativiteti në veprimtarinë ftuese" në Tetovë punuan disa grupe me studentë, grupe të udhëhequra nga trajnuesi në fjalë.



HIXHRI 1439/2017

Për të shtatëmbëdhjetën herë me radhë u organizua manifestimi "**Në gjurmët e më të mirëve**". Në këtë manifestim u shpërblyen:

- Nxënësit më të mirë të shkollave të mesme nga Maqedonia
- Studentët e dalluar nga pesë universitetet e vendit
- **Dr. Arlind Farizi**, fitues i çmimit "Shkencëtari i ri i vitit"
- **Hfz. Burak Iseni**, fitues i çmimit "Hafëzi i ri i vitit"
- Personalitete e subjekte për kontribut e arritje të veçantë
- **Emir Fetaj**, fitues i çmimit të veçantë, me rastin e përzgjedhjes si studenti më i mirë në mesin e 200 studentëve në Stamboll të Turqisë.

Manifestimi ishte i pasur edhe me disa pika artistike: interpretimi i recitaleve "**Rrugë të mbarë**" e "**Din dhe dije**" nga aktori **Adrian Aziri** si dhe interpretimi i ilahive nga kënduesi i mirënjohur **Mesut Kurtish**.





MANIFESTIMI I MUHAMEDIT A.S.

Manifestimi u mbajt në Kumanovë, me program tëpasur edukativ e kulturor. Programi përfshiu: lexim Kurani nga **hfz. Daut Lezi**, ligjëratë me temë "*Urtësia e Muhamedit a.s.*" nga hoxhë **Fidaim Fazliu**, interpretim ilahish nga **Nderim Alimi**. Pikë artistike u paraqit drama "*Tre të mbeturit në shpellë*" si dhe në fund u bë ndarja e çmimit "*Hafiz Refik Ajeti*".

Pos manifestimit qendror, u realizua edhe aktiviteti "*Njihuni me Muhamedin (a.s), udhëzuesin për kërkim të diturisë*", ku në Tetovë për studentët u shpërndanë fletushka bashkëngjitur me hadithin profetik për kërkimin e diturisë shoqëruar me trëndafilja.



ARRITJET E VITIT

FRI pjesë e bordit udhëheqës në FEMYSO

FEMYSO (Forum of European Muslim Youth and Student Organisations) - Forumi i Organizatave Rinore dhe Studentore Myslimane Europiane, në Kolonjë të Gjermanisë, këtë vit mbajti kuvendin e 21, ku u zgjodh kryesia e re për periudhën 2017-2019. Në kuvend morën pjesë përfaqësuesit e organizatave nga e gjithë Evropa që janë anëtare në FEMYSO, poashtu edhe përfaqësues të FRI-së. Forumin Rinor Islam në këtë mandat do ta përfaqësojë Vullnet Selmani, i cili u zgjodh edhe përgjegjës për financat.



Paraqitja e FRI-së, më e mira në Asambleenë Botërore të Rinisë Myslimane

"Të rinjtë proaktiv" ishte tema e seminarit të organizuar në Sarajevë nga Asambleja Botërore e Rinisë Myslimane. Forumi Rinor Islam në këtë seminar u përfaqësua nga anëtarët Vullnet Selmani dhe Abdulhamid Mustafa, të cilët prezantuan FRI-në dhe prezentimi u perzgjodh më i miri nga prezentimet të cilët u bënë në këtë seminar.



FRI u shpërblye me çmimin "Social Justice Award"

FEMYSO, me rastin e 20 vjetorit të themelimit të saj, shpërbleu Forumin Rinor Islam me çmimin "Social Justice Award", për veprimtari të suksesshmenë sferën e të rinjve dhe sektorin civil.

Njëashtu, FRI mori pjesë edhe në punëtorinë e organizuar për organizatat anëtare me titull: "Menaxhimi financiar dhe tërheqja e fondeve institucionale".

Në këtë ngjarje, FRI u përfaqësua nga **Berat Limani**, nënkryetar i organizatës dhe **Mevlan Zendeli**, anëtar.



FRI pjesë e grupit rinor këshillues të organizuar nga OSBE

Ky takim u realizua me kryesinë e OSBE - së, ministrin e jashtëm të Austrisë, Sebastian Kurz, ministrin e jashtëm të Maqedonisë si dhe shefen e misionit të OSBE - së në Shkup, ambasadorja Nina Suomalainen. Ndërkaq përfaqësues i Forumit Rinor Islam ishte Bujar Muça.




PARAQITJA E FRI-SË, BASHKËPUNIMET ME INSTITUCIONE DHE MEDIUME

BASHKËPUNIMI ME PORTALE DHE TELEVISIONE

Aktivitetet e FRI-së u përcollën nga shumë medime, nga televizionet shtetërore, televizionet lokale, televizionet nacionale, gazeta e shkruar si dhe nga shumë medime elektronike nga Maqedonia si dhe vendet tjera fqinjë.

Këshilla ramazani

- Nën moton **"Ramazani, muaji rizgjimit"**, me hoxhallarë të ndryshëm u realizuan këshillat e Ramzanit, të cilat u transmetuan nga televizionet lokale në disa qytete të Maqedonisë.



BASHKËPUNIMET ME OJQ DHE INSTITUCIONE

FRI forcoi lidhjet me institucionet dhe organizatat e vendit dhe jashtë, me anë të bashkëpunimeve në aktivitete, shkëmbimit të letrave me raste të veçanta, vizitave nga ana e kryetarit dhe vizitat e bëra në FRI. Poashtu, u krijuan edhe bashkëpunime të reja. Disa nga institucionet nga vendi dhe jashtë që u vizituan nga kryetari i FRI-së dhe që vizituan FRI-në përfaqësues të tyre:



Në Maqedoni, vizitë:

Kryetari të komunës së
Dollnenit, Xhemil Qamiloskit
Organizatës "Marif"
Kryetari të komunës së
Studenicanit
Fondacionit "Albiz"
Ambasadës së Britanisë
në Maqedoni
Ambasadës së SHBA-së
në Maqedoni
OSBE-së



Në Turqi, vizitë:

Organizatës "Yedi Hilal"
Organizatës "IHH"
Fondacionit rinor "Tugva"
Komunës së Bursës



Në Saudi, vizitë:

Ligës Botërore Myslimane
Organizatës ndërkombëtare
të ndihmës islamike
Fondacionit të Katarit

KUVENDET RAPORTUESE

Fillimisht degët, në qytetet ku është e shtrirë FRI-ja, mbajtën kuvendet raportuese dhe më pas u mbajt edhe kuvendi qendror i FRI-së. Para kuvendarëve, kryetari i përgjithshëm i FRI-së shpalosi punën njëvjeçare të organizatës, më pas me ndryshimet e paraqitura raporti u miratua. Poashtu, u paraqit dhe u miratua edhe raporti financiar.





Raporti i vitit 2018

SHËNIMI I DITËVE TË VEÇANTA

Dita Botërore e Mbulesës

Dita Botërore e Mbulesës u shënuar me një panel diskutimi me temë “Femra në pas modernitet, mes shfaqjes së identitetit të saj dhe paragjyqimeve.” Paneliste ishin psikologe Mr. Alije Alimi dhe juriste Mr. Xhemile Saliu. Qëllimi i këtij paneli ishte orientimi i grave me mbulesë që hasin paragjyqime dhe diskriminime të ndryshme në përditshmëri dhe institucione.



Dita e Flamurit

Me rastin e 28 nëntorit FRI shpërndau fleturime dhe karafila për kalimtarët e rastit në qytetin e Tetovës.



Dita e Mësuesit, 7 Marsi

Me rastin e 7 marsit, Ditës së Mësuesit, u realizua kuiz i diturisë në Kumanovë me shkollarë të mesëm të përzgjedhur nga tri shkollat e mesme të qytetit, punën e të cilëve e ndoqi dhe e vlerësoi komisioni në përbërje të tre profesorëve nga këto shkolla.



AKTIVITETE ME STUDENTËT DHE NXËNËSIT

Eureka

Fjala "Eureka" ka kuptimin e zbulimit pas një kërkimi të gjatë, konkretisht zbulimin e potencialeve të nxënësve pas trajnimeve që do t'i ndjekin. Dobësimi i fuqisë potenciale tek të rinjtë, zbehja e vetëdijes për rëndësinë e edukimit dhe rrezikshmëria e rrjeteve sociale janë disa nga sfidat kryesore njëkohësisht dhe shkaktojnë FRI e pa të nevojshme prezencën e një projekti reformues për të rinjtë e shkollave fillore.



Ky projekt synon zhvillimin dhe ngritjen e gjeneratave më të reja të shkollave fillore sipas parimeve dhe vlerave që çdo herë kanë qenë dobiprurëse dhe dëshmuere për përparim. Pjesëmarrës ishin afër 60 semimaturantë më të dalluar të qytetit të Shkupit dhe rrethinës. Disa nga trajnimet ishin "Menaxhimi i vetes në kohë", "Kimia e mjedisit jetësor", "Të mësuarit efikas". Projekti përfundoi me paraqitje të grupeve të nxënësve para publikut në përmbylljen solemne.



Projekti Socratium

Projekti Socratium këtë vit u realizua për herë të parë në Kumanovë me nxënësit e shkollës ekonomike “Pero Nakov”. Trajnimet psikologjike rreth njohjes së vetes, njohjes së të tjerëve dhe identifikimit të problemeve në bazë të pyetësorit MBTI ishin pjesë e këtij projekti.



Takime me maturantët

Në bashkëpunim me unionet e nxënësve të shkollave të mesme të qytetit të Shkupit, u organizuan trajnimet “Orientimi profesional” me psikologjen **Edlira Destani** dhe “Tejkalimi I krizave rinore” me hoxhë **Fevzi Musliun**.

Për vitin akademik 2018/2019 u realizuan trajnimet “Tejkalimi i pengesave rinore” me trajnues **Leonard Kaja**, “Orientimi profesional” me prof. **Mevludin Ibish** dhe “Si të përgatitet një punim seminarik” me Mr. **Burhanedin Nuhiju**.





Kursi i matematikës

Për dy muaj rresht u realizua kursi matematikës me nxënësit pjesëmarrës në projektin “Eureka” në Shkup.



Të rejat aktive

Projekt risi i cili u realizua në Shkup me vajza të shkollave të mesme për 10 javë me tema si “Shoqëria e shëndoshë”, “Lidershipi”, “Suksesi në grup”, “Hulumtim në bibliotekë” etj. Kryesisht këto takime javore u realizuan në formë bashkëbisedimi të udhëhequra nga anëtare të FRI – së. Qëllimi i këtij projekti ishte ngritja e aspektit edukativ, orientimi i të rejave drejt një vizioni të qartë personal, nxitja dhe motivimi i tyre për zhvillim personal.



“TË REJA aktive”



Ligjërata

U realizuan një numër i madh i ligjëratave të hapura të cilat organizohen nga Departamenti i Femrës, degët dhe nëndegët e FRI – së, me qëllim të nxitjes së studentëve e nxënësve drejt njohjes dhe përkushtimit ndaj Zotit, kërkimin e modeleve dhe formimin e personalitetit shembull në shoqëri. Ligjëratat ishin javore, dyjavore dhe mujore. Ndërkaq ligjërues ishin: **Fevzi Musliu, Hasan Baftijari, Mevlan Abazi, Sumeje Peza, Qamil Rushiti, Omer Dauti, Ardian Sejdiu dhe Taha Këllënç** nga Turqia.



Takim me studentët nga fakultetet e Turqisë

Në këtë takim të pranishëm ishin nxënësit e interesuar për studime në Republikën e Turqisë të cilët u informuan më shumë reth përparësive dhe mundësive për studime në universitetet e Turqisë, të cilat në mënyrë të detajuar i elaboruan studentët shqiptarë të cilët studiojnë atje duke treguar për eksperiencat e tyre.



Qendra Rinore

Në qendrën rinore të FRI-së gjatë vitit 2017/2018 banuan 80 studentë nga e gjithë Maqedonia. Gjatë këtij viti akademik, me studentët e kësaj qendre u zhvillua ky program: programi edukativ, aktivitete sportive dhe argëtuese, trajnime për studentët, përgatitje e punimeve studentore si dhe vizita dhe shëtitje.



RAMAZANI

Mirëpritje e muajit Ramazan

Së bashku me shumë qytetarë u prit muaji Ramazan në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, me manifestimin tradicional “Mirëseerdhe muaji Ramazan”.

Shënimi i fillimit të muajit Ramazan u bë edhe në qytetin e Tetovës me shpërndarjen e hurmave dhe lutjes së iftarit për kalimtarët e rastit në qytet.

Kumanova zbukuroi qytetin me banderola me moto: “Ramazani, muaji i vetëdijesimit”, “Ramazani, muaji i mirësisë” si dhe “Ramazani, muaji i freskisë shpirtërore”.



Mbrëmjet Kuranore

Mbrëmjet Kuranore, me lexues të shquar nga vendi u realizuan me sukses në Çarshinë e Vjetër të Shkupit dhe në Kërçovë.

Lexuesit: *hfz. Jasin Abdullahu, hfz. Jetmir Zendeli, hfz. Adnan Elmazi.*





Netët e kulturës islame

Ky aktivitet u realizua në sheshin e qytetit të Kumanovës, me program të pasur kulturor, artistik, fetar e arsimor si: fjalime motivuese, interpretim monologjesh, kuizi i diturisë, panairi i librave, ëmbëlsirave dhe këndi i henasë. Gjithashtu u shpallën edhe semimaturantët më të mirë të vitit.

Në Tetovë u organizua Kampusi i Ramazanit për femra, i cili ngërtheu faljen e namazeve së bashku, ligjëratë dhe iftar.



Iftare

Në sheshin e qytetit të Kumanovës u organizua iftari i madh tradicional. Të pranishëm ishin mbi 500 persona dhe atë të përkatësive të ndryshme fetare, e kombëtare, si dhe përfaqësues të institucioneve lokale e organizatave joqeveritare.

Iftare u shtruan edhe në Shkup, Tetovë, Kërçovë dhe Prilep me anëtarë, aktivistë dhe dashamirë të FRI-së.



Shpallja e semimaturantëve

Nën moton "Investo për diturinë, siguro ardhmërinë", u shpërblyen semimaturantët më të mirë në Kërçovë. Për dallim nga vitet e kaluara ky aktivitet në Tetovë dhe Prilep u realizua në mbrëmjen e iftarit të degëve, ndërkaq në Kumanovë në kuadër të Netëve të kulturës islame.





Shporta e Ramazanit

Shportat u shpërndanë për qindra familje nevojtare. Në Kumanovë u mbledhën 1964 shporta në bashkëpunim me Sh.E. "Vllaznia" kurse në Tetovë 2238 shporta në bashkëpunim me marketet "Ramstor".



Koncerti I Bajramit

Ky koncert u realizua në qendër të qytetit, me këndues të mirënjohur nga Maqedonia dhe Kosova, si: Egzon Ibrahimi, Xhemail dhe Sabatin Nuhiju, Ylber Aliu, Nderim Alimi, Dardan Ramadani, Avni Nebiu dhe grupi "Zijadin Ismaili". Në fund të programit u bë lansimi i fishekzjarreve.



AKTIVITETE ME AKTIVISTË

Aktivite edukative

Shkolla edukative, takime ,si dhe aktivite tjera si mbrëmje imanore, mexhlise, iftare vullnetare, klubi i librit u realizuan me aktivistë nëpër degët e FRI - së.

Aktivite të lira argëtuese

Aktivite të lira argëtuese si: pikniqe, kampingje, ekskursionet njëditore u zhvilluan në disa qytete me anëtarë e aktivistë nëpër vende të ndryshme të Maqedonisë me qëllim të afrimit dhe ripërtërimit pas angazhimeve nëpër aktivite të ndryshme. Në pranverë të këtij viti u realizua piknik i përbashkët i të gjitha degëve, me rreth 60 anëtarë.



Seminare

Në Kumanovë u realizua një cikël seminaresh me temë *“Dhjetë cilësitë e muslimanit bashkëkohor”*. Ndërkaq në Shkup u realizuan seminarët: *“Vlerat e FRI - së”*, *“Menaxhimi i vetes drejt suksesit”* dhe seminar njëditor me pjesëmarrësit e projektit *“Eureka”*.



HIXHRI

Në gjurmët e më të mirëve

Për të tetëmbëdhjetën herë me radhë u organizua manifestimi "Në gjurmët e më të mirëve". Në këtë manifestim u shpërblyen:

- *Nxënësit më të mirë të shkollave të mesme nga Maqedonia*
- *Studentët e dalluar nga pesë universitetet e vendit*
- **Dr. Mevludin Memedi**, fitues i çmimit "Shkencëtar i ri i vitit"
- **Hfz. Muaz Ajrullau**, fitues i çmimit "Hafëzi i ri i vitit"
- *Personalitete e subjekte për kontribut e arritje të veçantë*
- **Zulejha Imeri**, fituese e çmimit të veçantë, me rastin e përzgjedhjes si studentja më e mirë e gjeneratës në Fakultetin Ekonomik në Stamboll të Turqisë.
- *Pika artistike të kësaj mbrëmje ishin paraqitja e monologut "Elif" nga **Genci Mirzo** me tekst të Fatmir Mujës dhe interpretimi i ilahive nga **Egzon Ibrahim**.*





FUSHATA “TA NJOHIM MUHAMEDIN A.S.”

Manifestimi u mbajt në Kumanovë, me panel diskutimi nga studentët anëtarë/aktivistë të FRI-së të cilët prezantuan jetën dhe veprën e **Muhamedit a.s** nga aspekti i tyre profesional. Programi përfshiu edhe disa pika artistike.



AKTIVITETE

FRI mori pjesë në takime të realizuara nga FEMYSO

Anëtarë të FRI-së ishin prezent në disa takime të realizuara nga FEMYSO (Forum of European Muslim Youth and Student Organisations) - Forumi i Organizatave Rinore dhe Studentore Myslimane Europiane. Takimet u realizuan në Tiranë, Budapest, Bruksel, Sarajevë, Rroterdam ku ishin prezent Liridon Ismaili, Fuat Shabani, Ejup Memeti, Kujtesa Xheladini dhe Vullnet Selmani si përgjegjës i financave i kësaj organizate.

FRI pjesë e seminarit nga Organizata Botërore të Rinjve Muslimanë

Forumit Rinor Islam mori pjesë në seminarin e 23-të me radhë që realizohet nga Organizata Botërore e të Rinjve Muslimanë në Bosnje dhe Hercegovinë. Abdulhamid Mustafa, kryetar i FRI – Dega Shkup dhe Vullnet Selmani, anëtar i kryesisë e përfaqësuan FRI-në në këtë seminar, ku u paraqitën me tema të ndryshme profesorë të dalluar nga Arabia Saudite.

FRI pjesëmarrëse në takimin vjetor të Unionit të Shqiptarëve Muslimanë në Itali

Në organizimin vjetor, të njëmbëdhjetin me radhë të Unionit të Shqiptarëve Myslimanë të Italisë. Nga FRI pjesëmarrës ishin nënkryetari i organizatës, Hasan Baftijari, i cili ligjëroi në temën “E drejta e jetës, tjetri i ngjashëm dhe tjetri i ndryshëm” dhe Vullnet Selmani, anëtar i kryesisë qendrore të FRI-së, i cili prezantoi veprimtarinë e Forumit Rinor Islam dhe aktivitetet të cilat realizohen.

FRI ishte pjesë e platformës së OJQ-ve për përkrahjen e Referendumit.

FRI iu bashkua protestës “Drejtësi për Almirin” më 21 mars, para Qeverisë së RM-së, protestë kundër rikualifikimit të lëndës.

Media

Aktivitetet e FRI-së u përcollën nga shumë medime, nga televizionet shtetërore, televizionet lokale, televizionet nacionale, gazeta e shkruar si dhe nga shumë medime elektronike nga Maqedonia si dhe nga vendet tjera fqinjë.



AKTIVITETET E PUBLIKUARA NË UEB FAQE DHE RRJETE SOCIALE


Përveç publikimeve të rregullta të lajmeve, lajmërimeve në uebfaqen FRI, në rrjetet Facebook dhe Instagram janë publikuar edhe disa projekte si:

- Video Shënimi i 23 Prillit Ditës së Librit,
- 30 video Këshilla Ramazani nga anëtarë dhe aktivistë,
- Cikël videosh “Njeriu që do Muhamedin a.s”
- Përkujtues agjërimi
- Lajmërime, dizajne etj.
- Urime me rastin e shënimit të festave kombëtare si Dita e Flamurit, Dita e Alfabetit.



KUVENDET RAPORTUESE

Fillimisht u mbajtën kuvendet e degëve ku u raportua për aktivitetet në degët përkatëse gjatë këtij viti. Pastaj, u mbajt edhe kuvendi raportues vjetor i përgjithshëm. Para kuvendarëve, kryetari i përgjithshëm i FRI-së shpalosi punën njëvjeçare të organizatës, më pas me ndryshimet e paraqitura raporti u miratua. Poashtu, u paraqit dhe u miratua edhe raporti financiar.



Raporti i vitit 2019

SHËNIMI I DITËVE TË VEÇANTA

Dita Botërore e Mbulesës

Dita Botërore e Mbulesës u shënua me aktivitetin e realizuar në qendër të qytetit të Kumanovës në të cilin u promovua shkencë, arti dhe diversiteti. Programi i këtij aktiviteti përfshiu tre kënde edhe atë të provimit të shamive, këndi i kreativitetit dhe këndi i shkencës. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte vetëdijesimi i femrave për të drejtën e shfaqjes së identitetit dhe hapja e rrugëve të kuptimit dhe pranimit të mbulesës.

Departamenti i Femrës realizoi edhe një fushatë mediatike për disa ditë me radhë me postimin e thënieve të anëtareve dhe aktivisteve të FRI – së, të cilat studiojnë dhe punojnë në profesione të ndryshme duke shfaqur vlerat, kontributin dhe universalitetin e femrave në shoqërinë tonë.



AKTIVITETE ME STUDENTËT DHE NXËNËSIT

Projekti “Eureka”

Në Shkup, FRI realizoi projektin “Eureka”, projekt ky i cili u realizua për herë të dytë gjatë vitit 2019 me nxënës të shkollave fillore, më saktësisht semimaturantë të përzgjedhur nga shkollat e Shkupit dhe Studeniçanit. Në këtë projekt u përfshinë 8 shkolla, me gjithsej 50 nxënës.

“Menaxhimi i vetes në kohë”, “Të mësuarit lehtë dhe shpejt”, “Rrjetet sociale”, “Kimia e ambientit jetësor” dhe “Shëndeti oral” ishin temat e trajnimeve të cilat u realizuan me trajnues profesional nga ana e FRI-së. Pjesë e projektit ishin edhe shëtitjet dhe vizitat e disa vendeve historike. Nxënësit pjesëmarrës në përfundim të projektit, e cila u mbajt në Qendrën Informativ Kulturore, para publikut dolën me paraqitje në grupe, duke folur kryesisht për temat që janë shtjelluar në trajnimet e këtij projekti.



Projekti Sokratium

Projekti "Sokratium" vazhdoi edhe këtë vit me ciklin e dytë në Kumanovë me nxënësit e shkollave të mesme. Trajnimet rreth formimit dhe besimit në grup, si dhe "Teknikat e të mësuarit efektiv" ishin pjesë e këtij projekti. Në përmbylljen e këtij projekti u realizua fjalim motivues nga përgjegjësjja e projektit, si dhe u ndanë certifikata për nxënësit pjesëmarrës.



Të rejat aktive/Të rinjtë aktivë

Rreth 60 nxënës të shkollave të mesme nga Shkupi dhe Karshiaka, për 10 javë radhazi u bënë pjesë e këtij projekti. Temat që u trajtuan: “Shoqëria e shëndoshë”, “Lidershipi”, “Suksesi në grup”, “Hulumtim në bibliotekë”.

Qëllimi i këtij projekti ishte ngritja e aspektit edukativ, orientimi i të rinjve drejt një vizioni të qartë personal si dhe nxitja dhe motivimi i tyre për zhvillim personal.



FRI festë me maturantet e Kumanovës

Ky organizim solemn nga FRI u realizua për aktivistet që kurorëzuan me sukses etapën katër vjeçare të shkollimit të mesëm me ç'rast u shtrua darkë dhe u realizuan disa aktivitete tjera të lira. Maturanteve iu dhurua edhe nga një dhuratë modeste, libra të hoxhë Jakup Asipit.



Trajnime


FRI këtë vit realizoi trajnimin falas “Si të shkruajmë CV dhe letër motivuese” për studentët në Tetovë. Trajnues në këtë aktivitet ishte **Mr. Vullnet Selmani**. Për 15 pjesëmarrësit u shpërndanë certifikata pjesëmarrjeje.



Ligjërata

U realizuan një numër i madh i ligjëratave të hapura të cilat organizohen nga Departamenti i Femrës, degët dhe nëndegët e FRI – së, me qëllim të nxitjes së studentëve e nxënësve drejt njohjes dhe përkushtimit ndaj Zotit, kërkimin e modeleve dhe formimin e personalitetit shembull në shoqëri.

Ligjërues ishin: **Hasan Baftijari, Sumeje Peza, Fevzi Musliu, Nuhi Ganija, Ardian Sejdiu dhe Musa Musai.**



Qendra Rinore

Në Qendrën rinore të FRI-së gjatë vitit 2017/2018 banuan 80 studentë nga e gjithë Maqedonia. Gjatë këtij viti akademik, me studentët e kësaj qendre u zhvillua ky program: programi edukativ, aktivitete sportive dhe argëtuese, trajnime për studentët, përgatitje e punimeve studentore si dhe vizita dhe shëtitje.

RAMAZANI

Mirëpritje e muajit Ramazan

Së bashku me shumë qytetarë u prit muaji Ramazan në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, me manifestimin tradicional *“Mirë se erdhe muaji Ramazan”*. Pikat e këtij manifestimi ishin: leximi i disa ajeteve kuranore nga hfz. Xhemal Nuhiu, ilahitë e kënduara nga Menduh Allajbegu dhe monologu nga Medin Bajrami.

Shënimi i fillimit të muajit Ramazan u bë edhe në qytetin e Tetovës me shpërndarjen e hurmave dhe lutjes së iftarit për kalimtarët e rastit në qytet.

Kumanova zbukuroi qytetin me banderola, të cilat u vendosen në tri pikat më frekuentuese të qytetit me mbishkrimet *“Ramazani, muaji i vetëdijesimit”*, si dhe *“Ramazani, muaji i freskisë shpirtërore”*.

Banderola me mbishkrimin e urimit të Ramazanit u vendosën edhe në Sllatinë të Tetovës dhe u bë shpërndarja e imsakijeve për banorët.



Netët e kulturës islame

Ky aktivitet u realizua në sheshin e qytetit të Kumanovës me program të pasur kulturor, artistik, fetar e arsimor si: fjalime motivuese, interpretim monologjesh, kuizi i diturisë, panairi i librave dhe ëmbëlsirave, dokumentar dhe këndi i kreativitetit. Gjithashtu u shpallën edhe semimaturantët më të mirë të vitit.







Iftare

Në sheshin e qytetit të Kumanovës u organizua iftari i madh tradicional. Të pranishëm ishin mbi 500 persona dhe atë të përkatësive të ndryshme fetare, e kombëtare si dhe përfaqësues të institucioneve lokale e organizatave joqeveritare.

Iftare u shtruan edhe në Shkup, Tetovë, Kërçovë dhe Prilep me anëtarë, aktivistë dhe dashamirë të FRI-së.



Ligjërata

Në kuadër të këtij muaji u realizuan disa ligjërata edhe atë në Kërçovë dhe Prilep.

Ligjërues ishin *Prim. Dr. Med. Sc. Ali Iljazi* nga Gjakova, teolog **Tahir Zenelhasani** kryetar i shoqatës "Ardhmëria" në Shqipëri, **Qamil Rushiti**, dhe teolog **Fevzi Musliu**.



Shpallja e semimaturantëve

Nën moton **"Investo për diturinë, siguro ardhmërinë"**, u shpërblyen semimaturantët e dalluar në Tetovë. Edhe këtë vitë ky aktivitet në Tetovë u realizua së bashku me iftarin tradicional, ndërsa shpallja e semimaturantëve të dalluar të Kumanovës u bë në kuadër të Netëve të kulturës islame.





Programi solemn “Ramazani, muaji i dashurisë”

Departamenti i Femrës në Shkup realizoi programin solemn me rastin e muajit të Ramazanit, me aktivistet dhe anëtarët më të reja. Pikat e këtij programi ishin: këndimi i disa ilahive, paraqitje të një monologu, dialogu dhe disa lutje.

Vizitë fëmijëve me nevoja të veçanta

Në prag të festës së Bajramit, FRI vizitoi shkollën e fëmijëve me nevoja të veçanta “Sadakaja” në Kumanovë, me ç'rast iu dhuruan edhe pako me produkte të nevojshme për ta.



Kuizi i diturisë

Dega në Prilep realizoi aktivitetin “Kuizi i diturisë” në hapësirat e xhamisë Bedër të fshatit Cërnilishtë, në të cilin kuiz garues ishin të rinjtë e vendit.

Shporta e Ramazanit

Shportat u shpërndanë për qindra familje nevojtare. Në Kumanovë u mblodhën rreth 2000 shporta. Poashtu 2000 shporta u mblodhën edhe në Tetovë në bashkëpunim me Organizatën Humanitare “Kalliri i Mirësisë”.



Koncerti i Bajramit

Ky koncert u realizua në qendër të qytetit në bashkëpunim me shoqatën “Vllaznia” me këndues të mirënjohur nga Maqedonia dhe Kosova, si: Nusret Kurtishi, Dardan Ramadani, Avni Nebiu, Daut Lezi dhe Avdush Krosa. Në fund të programit u bë lansimi i fishekzjarreve.



AKTIVITETE ME AKTIVISTË

Aktivite edukative

Shkolla edukative, takime si dhe aktivitete tjera si mbrëmje imanore, mexhlise, iftare vullnetare , kursi i Kuranit dhe klubi i librit u realizuan me aktivistë nëpër degët e FRI – së.

Aktivite të lira argëtuese

Aktivite të lira argëtuese si: pikniqe, kampingje, ekskursionet njëditore u zhvilluan në disa qytete me anëtarë e aktivistë nëpër vende të ndryshme të Maqedonisë me qëllim të afrimit dhe ripërtërimit pas angazhimeve nëpër aktivitete të ndryshme.



Aktivitetet sportive

Degët e FRI-së, gjatë vitit 2019, realizuan aktivitete të ndryshme sportive, kryesisht lojëra futbollistike.



Seminare

Në Kumanovë u realizua një cikël seminaresh me temë "Dhjetë cilësitë e muslimanit bashkëkohor". Gjatë këtij cikli u mbajtën disa takime me ligjërues të ndryshëm si hoxhë Hasan Baftijari, hoxhë Fevzi Musliu, hoxhë Rufat Sherifi, Dr. Rabie Mustafa, Mr. Milazim Mustafa, Arsim Jonuzi, Sead Ramadani.

Seminari veror në Çanakale të Turqisë

Seminari veror me aktivistë, nxënës dhe studentë në Çanakale të Turqisë kishte karakter edukativo-aftësues, në të cilin përveç ligjëratave pjesë e programit ishin edhe aktivitetet rekreative, vizitat disa vendeve dhe monumenteve historike.

Trajnim me udhëheqësinë e organizatës ndërkombëtare FEMYSO

Aktivistët e FRI nga të gjitha degët ku vepron kjo organizatë ndoqën trajnim njëditor me trajnues ndërkombëtarë nga bordi drejtues i FEMYSO-s nga Zvicra, Anglia, Franca, Gjermania dhe Shqipëria. Temat e trajnimeve ishin "Të menduarit strategjik" dhe "Planifikimi i eventeve".



HIXHRI 1441

Në gjurmët e më të mirëve

Për të nëntëmbëdhjetën herë me radhë u organizua manifestimi "Në gjurmët e më të mirëve". Në këtë manifestim u shpërblyen:

- *Nxënësit më të mirë të shkollave të mesme nga Maqedonia e Veriut*
- *Studentët e dalluar nga pesë universitetet e vendit*
- **Dr. Argëtim Saliu**, fitues i çmimit "Shkencëtar i ri i vitit"
- **Motrat Azra dhe Sara Demiri**, fituese të çmimit "Hafizet e reja të vitit"
- *Personalitete e subjekte për kontribut e arritje të veçantë*
- *Pika artistike të kësaj mbrëmje ishin paraqitja e monologut "Fjalët e një kalorësi" nga Genci Mirzo me tekst të Fatmir Mujës dhe interpretimi i ilahive "Ezani i pambaruar" dhe "Emri Muhamed", të shkruara enkas për këtë manifestim poashtu nga Fatmir Muja, të cilat i interpretoi Musli Musliu.*





FUSHATA “TA NJOHIM MUHAMEDIN A.S.”

Manifestimi u mbajt në Kumanovë, me program edhe atë:

- *lexim Kurani nga Sabaatin Nuhiju*
- *ilahi nga Nderim Alimi*
- *ligjëratë nga Ardian Sejdiu*
- *monolog nga Emira Rexhepi*

Me rastin e muajit të lindjes së Muhamedit a.s u organizuan ligjërata fetare edhe në Tetovë me teologun **Ardijan Sejdiu** me temë “*Muhamedi alejhis-selam dhe ndërtimi i shoqërisë*” dhe në Karshiakë të Shkupit me Mr. Musa Musain me temë “*Muhamedi a.s. trëndafili i mëshirës që mbiu mbi rërën e shkretëtirës*”.





FRI NË SHUMËLLOJSHMËRI AKTIVITETESH DHE BASHKËPUNIMESH

FRI pjesë e iniciativës për ambient më të pastërt

Forumi Rinor Islam ishte pjesë e iniciativës për një ambient më të pastërt dhe ekologjik të organizuar nga Higjiena Komunale - Shkup. Me këtë aktivitet u përcoll mesazhi deri te të gjithë qytetarët për kujdesin e hedhjes së mbeturinave dhe ruajtjen e ambientit jetësor.



FRI mori pjesë në seminar në Sakarja të Turqisë

FRI mori pjesë në seminarin katërditor me studentë të vendeve të ndryshme të botës, e organizuar nga organizata Anadolu Platformu Ogrenci që vepron në Republikën e Turqisë. Dhjetë studentë të cilët janë anëtarë të Forumit Rinor Islam ishin pjesëmarrës në këtë seminar, në të cilin u shtjelluan shumë tema dhe u organizuan grupe të ndryshme punuese.



FRI mori pjesë në seminarin e organizuar nga Fondacioni AXIS

Forumi Rinor Islam mori pjesë në seminarin dyditor të realizuar nga Fondacioni AXIS me temë: "Menaxheri dhe roli i tij në organizatë" me trajnues Prof. Dr. Gadaf Rexhepin. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin kryesisht anëtarët e kryesisë qendrore të FRI-së.



FRI në takim me kryesinë e organizatës ndërkombëtare FEMYSO

Forumi Rinor Islam mirëpriti në Shkup bordin udhëheqës të Forumit Evropian të Rinjve Muslimanë dhe organizatës studentore FEMYSO nga ku realizuan takime të përbashkëta ndërmjet dy kryesive, kështu duke prezantuar punën e të dyja organizatave. Gjithashtu u diskutua mbi sfidat dhe mundësitë me të cilat ballafaqohen këto dy organizata dhe në përfundim të takimit u konstatua nevoja për ta thelluar edhe më shumë bashkëpunimin i cili do të jetë i dobishëm për të dyja palët.



FRI fitoi çmimin "The best event of the year"

Me rastin e asamblesë së përgjithshme të Forumit të Organizatave Rinore dhe Studentore Muslimane në Evropë (FEMYSO), aktiviteti i Forumit Rinor Islam, "Në gjurmët e më të mirëve" u përzgjedh si aktiviteti më i mirë ndër aktivitetet e shumë organizatave tjera të cilët veprojnë në Evropë. Kjo ngjarje u realizua në Dublin, ku nga Forumi Rinor Islam morën pjesë kryetari i FRI-së Fisnik Shabani, nënkryetari Berat Limani dhe anëtarë të kryesisë Vullnet Selmani.



VIZITAT FRI – SË DHE NGA FRI



Vizitë nga Rektori i Universitetit Internacional Balkanik



Vizitë Komunës së Likovës



Vizitë Komunës Çair



Vizitë nga Fondacioni "Axis"



Vizitë Komunës Haraçinë

Raporti i vitit 2020

SEMINARI “STAFF RETREAT 2020”

Seminari Staff Retreat, u realizua përgjatë periudhës kohore 10-13 Janar 2020 në Hotel Drim – Strugë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pjesëmarrës në këtë seminar ishin 52 persona edhe atë:

- Kryesia qendrore e FRI-së (kryetar, nënkryetarët, sekretari gjeneral si dhe anëtarë tjerë të kryesisë qendrore)
- Kryetar të degëve dhe kryesitë e degëve (Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Prilep)
- Trajnuesit dhe ligjeruesit – teolog

Staff Retreat u emërtua pasi që ky seminar i tuboi të gjithë anëtarët dhe aktivistët më aktiv të Forumit Rinor Islam në nivel republikan, ku bashkarisht u diskutuan biseda të rëndësishme për veprimtarinë e OJQ-së FRI, në fillim u bë rishikimi i aktiviteteve që janë realizuar nga FRI përgjatë periudhës katër vjeçare 2016-2019 në të gjitha qytetet ku shtrihet FRI, rishikimi i aktiviteteve ishte edhe një përkujtim se cilët aktivitete kishin bërë propagandë dhe ndikim më të madh tek popullata por edhe aktivitetet risi të cilët u realizuan për nxënës dhe studentët më të dalluar.



Pjesë e programit të seminarit ishin edhe ligjeratat fetare:

Tema: “Roli dhe Misioni njeriut në tokë”
Ligjerues: Hasan Baftijari

Tema: “Muslimani Produktiv”
Ligjerues: Vladimir Kera

Përveç trajnimeve të brendshme që ngërthenin planin strategjik, funksionimin e brendshëm të FRI-së, realizuam dy trajnime për aftësimin e pjesëmarrësve edhe atë në dy sfera:

1. Intelejjenca Emocional, - Endrit Maçi
2. Komunikimi Publik, - Endrit Maçi

Pas përfundimit të seminarit realizuam një shëtitje me të gjithë pjesëmarrësit në qytetin e Ohrit.



DITA E MBULESËS

Me rastin e shënimit të 1 Shkurtit "Ditës së Mbulesës", Forumi Rinor Islam realizoi disa video me mendime të personaliteteve nga vendi nën moton "Unitet në Diversitet".

Pjesëmarrës: Elisabeta Bajrami Ollogu, Edlira Destani, Nita Beluli, Amella Ismaili Cana, Jolanda Jajaga.



"COVID - 19, DËLIRËSOHU!"

Forum Risor Islam për të qenë vazhdimisht afër qytetarëve, veçanërisht afër të rinjve në periudhën e sfidës globale, me rastin e përhapjes së virusit Covid - 19 filloi me fushatën mediatike nën moton "Covid -19, Dëlirësohu!".

Fokusi i fushatës ishte në përcjelljen e këshillave për mbrojtjen, produktivitetin, dëlirësimin fizik dhe shpirtëror të gjithësecilit.

Forum Risor Islam
rekomandon:

**Covid-19
Dëlirësohu!**

mbroje veten, sepse kështu e
mbron tërë shoqërinë



**Qëndroni të shëndetshëm!
Qëndroni të sigurt!
Qëndroni në shtëpi!**

www.fri.org.mk

EDUKOJME, MOTIVOJME, FUQIZOJME



Besim

**Covid-19
Dëlirësohu!**



Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit,
le t'i bëjë mirë fqinjit të tij.

Muhamedi a.s.

**Qëndroni të shëndetshëm!
Qëndroni të sigurt!
Qëndroni në shtëpi!**

www.fri.org.mk

EDUKOJME, MOTIVOJME, FUQIZOJME



EUREKA

Projekti "Eureka" synon zhvillimin dhe ngritjen e gjeneratave më të reja të shkollave fillore sipas parimeve dhe vlerave që çdo herë kanë qenë dobiprurëse dhe dëshmuese për përparim.

Pjesëmarrës ishin afër 60 semimaturantë më të dalluar të qytetit të Shkupit dhe rrethinës.

Disa nga trajnimet ishin "Menaxhimi i vetes në kohë", "Shëndeti mental dhe varësia e rrjeteve sociale", "Të mësuarit efikas", "Menaxhimi i vetes në kohë".

Projekti përfundoi me një ligjeratë me temë "Mbrojtja nga Covid-19" me ligjerues Dr. Adhurim Fazliu, mjekë në ndihmën e parë.



RAMAZANI

“**Ramazani, muaji i unifikimit**” ishte motoja e fushatës së muajit Ramazan këtë vit, fushatë kjo e cila realizohet nga Forumi Rinor Islam tanimë disa vite.

Duke pas parasysh sfidën globale, përhapjen e virusit Covid - 19 në përmasa pandemike, Forumi Rinor Islam përkritazi me rregullat dhe rekomandimet e RMV - së ndryshoi formën e realizimit të shumë aktiviteteve pa iu munguar qytetarëve edhe këtë vit.

Me shfrytëzimin e teknologjisë dhe rrjeteve sociale u realizuan një numër i madh aktiviteteve si: “**Mirë se vjen muaji Ramazan**” manifestimi tradicional drejtpërdrejt në Facebook me lexim Kurani, fjalime përshëndetëse dhe ilahi.

Nga një numër i madh i shikuesve u ndoqën edhe videot “**Këshilla Ramazani**” me hoxhallarë të shumtë si dhe emisioni “**Islami dhe jeta**” i udhëhequr nga hoxhë **Hasan Baftijari** në të cilat emisione zhvillohej bashkëbisedim me mysafir të ndryshëm dhe kuiz me ndjekësit online me ç’rast për fituesit dhuroheshin libra me titull “**Jetëshkrimi i të Dërguarit a.s.**”.



Si aktivitet risi këtë vit ishte leximi i plotë i Kuranit Fisnik, çdo ditë nga një xhuz drejtpërdrejt nga Medina me hafiz **Ibrahim Sherifi** dhe mysafir disa hafizë të tjerë shqiptar dhe të huaj.

“**30 mësimë për agjëruesin**” të autorit Aid el Karni ishte cikli tjetër i videove i publikuar në faqen e FRI - së.

Çdo ditë janë postuar edhe përkujtues me hadithe profetike, ajete kuranore për muajin Ramazan si dhe përkujtim për kohën e iftarit, syfryrit dhe kohës së namazeve.





Shporta e Ramazanit

Forumi Rinor Islam tanimë disa vite me rradhë në kuadër të aktiviteteteve të muajit Ramazan organizon shpërndarje të shportave.

Këtë vit nën moton **“Ramazani, muaji i unifikimit”** ky aktivitet u realizua në qytetin e Kumanovës, Tetovës dhe Kërçovës.

Në tentat e vendosura të FRI - së dhe përmes linkut të xhirollogarisë për donim janë grumbulluar dhe shpërndarë gjithsej 5473 pako. Me vlerë nga 300 denarë 1485 shporta në Tetovë, 3040 shporta në Kumanovë, 833 pako në Kërçovë si dhe 115 në xhirollogarinë online.

Kryesisht pakot përmbanin produkte elementare ushqimore dhe higjienike.

Duke bashkëndjerë me familjet skamnore, jetimët dhe rastet sociale në këtë muaj të solidaritetit, të cilin këtë vit edhe më shumë u rëndua nga sfida globale e pandemisë Covid 19, FRI ofroi mundësi për të kontribuar të gjithë ata që kishin mundësi, me çka gëzuan zemrat e atyre që kanë nevojë më së shumti.

Ky aktivitet filloi që nga ditët e para të muajit Ramazan, në Tetovë në bashkëpunim me O.H. “Kalliri i Mirësisë” dhe marketet “Ramstore”, ndërda në qytetin e Kumanovës në bashkëpunim me SH.E. “Vllaznia” dhe marketet “Selman Turizem” dhe “Musli Market”.




HIXHRI 1442

Në gjurmët e më të mirëve

Për të njëzetën herë me radhë u organizua manifestimi "Në gjurmët e më të mirëve". Në këtë manifestim u shpërblyen:

- *Nxënësit më të mirë të shkollave qendrore të mesme nga Maqedonia e Veriut*
- *Studentët e dalluar nga pesë universitetet e vendit*
- **Dr. Eljesa Murtezi**, fitues i çmimit "Shkencëtar i ri i vitit"
- **Sead Idrizi**, fitues i çmimit "Hafizi më i ri i vitit"
- *Personalitete e subjekte për kontribut e arritje të veçantë*
- *Pika artistike të kësaj mbrëmje ishin paraqitja e monologut "Fjalët e qiririt" nga Arsim Fazlija me tekst të Naim Frashërit dhe interpretimi i ilahive "Dora e mëshirës", "Allah" dhe "Kamerun", të cilat i interpretoi Egzon Ibrahim.*





KUVENDET RAPORTUESE DHE ZGJEDHORE

Në qytetet ku është e shtrirë FRI-ja, u mbajtën kuvendet raportuese dhe zgjedhore.



Kuvendi i Degës Kumanovë



Kuvendi i Degës Tetovë



Kuvendi i Degës Shkup





JETËSO
SË KONTRIBUARI
NË NGRITJEN E NJË
KAPITALI SHOQËROR

QENDËR ËDUKATIVE RINORE

Edukim • Zhvillim • Orientim • Kreativitet • Moral • Kulturë
Kontinuitet • Bashkëpunim • Vullnetarizëm • Menaxhim
Inovacion • Vetëbesim • Kreativitet • Koncept • Dije
Profesionalizëm • Autenticitet • Resurse njerëzore
Motivacion • Lidership • Zotim • Analizë • Altruizëm
Fleksibilitet • Organizim • Sinqeritet • Avancim • Arsim



-  Rr. Çairska, nr. 1
1000 Shkup, Maqedoni
-  00389 2 3233 659
-  info@fri.org.mk
-  www.fri.org.mk